

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / РЕСПУБЛИКА КОСОВА	
MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE / MINISTARSTVA ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU	
SEKTOR I ARKIVIT / ARCHIVE SECTOR	
Niesia Org. Org. Number	2
Org. Unit	
Nr. ifaqe Br. stranica	2
No. pages	
Em. Prot. Doc. Prot.	4452
Data Date	25.09.2012
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Stalnoq Sekretar/Office of the Permanent Secretary

Nr. 4452 02-1
Dt: 25.09.2012

Në bazë të nenit 93 pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 4 pika 3 të Rregullores së Punës së Qeveris së Kosovës nr. 01/2007, nenit 41 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë dhe Udhëzimit Administrativ nr: 03/2003, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) nxjerr këtë:

V E N D I M

Licencohet Institucioni Arsimor Privat (IAP) “Cembridge School” në Pejë. Institucioni Arsimor Privat “Cembridge School” në Pejë do të ushtrojë veprimtarinë e vet edukative-arsimore në nivelin fillor (1), e mesëm të ulët (2) dhe të mesëm të lartë (3), drejtimet në nivelin e mesëm të lartë për drejtimet:

- Gjinnaz i Shkencave Natyrore dhe
- Gjinnaz Matematikë-Informatikë
- Gjinnazi Shoqëroro- Gjuhësor
- Mjekësi e Përgjithshme

A r s y e t i m

1. Komisioni për licencimin e IAP për nivelet arsimore 1, 2 dhe 3 sipas ISCED i ka udhëhequr të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe profesionale me qëllim të vlerësimit të kërkesës për licencim të Institucionit Arsimor Privat “Cembridge School” në Pejë, ka konstatuar se ky institucion i plotëson kushtet e dhe kriteret e përcaktuara ligjore për licencimin e drejtimeve të përfshira në pikën 1 të këtij vendimi për arsye se ai:

a) ka ofruar këto kushte dhe kritere:

- ka kërkesën me dokumentacionin e kompletuar,
- ka infrastrukturë shkollore të mjaftueshme dhe të përshtatshme me standarde të larta,
- ka laboratorë për lëmin përkatëse,
- ka kuadër mësimdhënës të kualifikuar,
- ka plan programe të pranuar nga MASHT,
- ka plan të specifikuar të biznesit,
- ka aktet e nevojshme nënligjore dhe

b) sipas vlerësimeve të komisionit të MASHT-it, ka ofruar shërbime-programe të avancuara për këtë nivel të shkollimit.

Udhëzime juridike: kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtrojë ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, në Gjykatën kompetente.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dorëzohet:

- Institucionit të Arsimit Privat
- Kabinetit të Ministrit / MASHT
- Zyrës së SP / MASHT
- Zyrës Inspektimit / MASHT
- Zyrës së Arsimit Privat / MASHT
- Arkivit


Xhavit Dakaj
Sekretar i Përgjithshëm





Institucioni Arsimor Privat The Cambridge School Pejë



PËR : Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Zyra për licencimin e Institucioneve Arsimore
Private të nivelit fillor dhe të mesëm
Prishtinë

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
KUVENDI I KOMUNËS PEJË
GJIMNAZI "CAMBRIDGE"

NR. 220/22
DATA 9.3.04.2012

LËNDA : Kërkesë për Vazhdimin e Licencimit të Institucionit Arsimor Privat

Bazuar në Ligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës (Ligji nr. 04/L-032) dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 03 /2003 të datës 22.01.2003 për licencimin dhe regjistrimin e institucioneve arsimore private të nivelit fillor dhe të mesëm, si dhe vendimin nr. 4945/02-1 të datës 10.10.2006, 701/2-1 të datës 20.06.2007, vendimit Nr. 505/2-1 të datës 05.10.2010 dhe vendimit Nr. 200/02-1 të datës 17.08.2011 për licencimin e Gjimnazi " Cambridge " në Pejë. Në emër të bordit të këtij institucioni **Kërkoj nga zyra për licencimin e institucioneve arsimore private, që të më mundësoj vazhdimin e PËRHERSHËM TË LICENCËS** për ushtrimin e veprimtarisë arsimore private në shkollimin e mesëm të nivelit 2 dhe 3 në drejtimet : Matematikë – Informatikë dhe Shkenca Natyrore.


Shkolla është e regjistruar në emër The Cambridge School pranë Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë më Nr. 70024508 dhe është me seli në Pejë, rruga Muharrem Mitrovica pn. Gjimnazi Cambridge posedon objekt shkollor më leje ndërtimi prej 1800 m², ka fushë sportive sipas standarteve shkollore dhe sallë për gjimnazistikë prej 600 m² si dhe leje pune Nr. 09/330/9420 lëshuar më 04.12.2008 nga Drejtoria për Financa, ekonomi dhe zhvillim komuna e Pejës. Institucioni Arsimor Privat Gjimnazi " Cambridge " i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga MASHT-i me Ligjin e Udhëzimit Administrativ të përmendura më lartë dhe është e pajisur konform standarteve evropiane të shkollimit.

Dokumentacioni i kompletuar sipas kërkesave të Ministrisë është në Zyrën për licencimin e institucioneve private për arsimin fillor dhe të mesëm pranë MASHT-it dhe i njëjti mund të vërtetohet në çdo kohë në Gjimnazin " Cambridge " në Pejë.

Andaj duke i marr parasysh këto fakte Kërkoj nga Zyra për licencimin e institucioneve arsimore private të nivelit dhe të mesëm, që ta licencoj IAP Gjimnazin " Cambridge " në Pejë më afat të përhershëm sipas Ligjit për arsimin Fillor dhe të mesëm në Kosovë.

Drejtori:

Jakup Beqaj, prof



Muharrem Mitrovica pn. 30000 Pejë

Tel. & Fax: + 381 39 432 188; 432 450; E-mail: info@gjcp-ks.com; ëëë: gjcp-ks.com